



PRANUAR ME: 19.07.2023
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/356



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë: 18.07.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -I- (parë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme 2024-2026.

Mbledhja u mbajt me datë: 29.06.2023 dhe filloi në ora: 09:45. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi,Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Gentianë Hoti, Rukije Bytyqi, Hamit Lima,Veton Zogaj, Sadik Vrenezi dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -I- (parë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa. Është mbledhje urgjente për arsye që 30 qeshori është afati i fundit për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore

Kush është për këtë rend dite?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme 2024-2026
Urdhëro,drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Sipas ligjit jemi në afatin e fundit për aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore, e qarkores së parë. Korniza afatmesme buxhetore për vitin 2024 përmban këta kufij buxhetorë: paga dhe medijtje 10,298,787.00E, mallra dhe shërbime-1,742,707.00, komunali -655,000.00E, subvensione dhe transfere-400,000.00E, Investime kapitale 7,299,312.00, Totali-20,395,806.00E. Kërkoj nga ju që ta rekomandoni për asamble shkaku i afatit kohorë që e kemi shumë të shkurtër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Sa e kam parë ka një rritje të buxhetit në bazë të qarkores për vitin 2024. Te pagat dhe medijtjet kemi një

rritje. Te Kuvendi, a hynë dhe pagat tona në këtë kategori. Unë ka me ngrit qështjen që te buxheti me pas buxhet dhe zyra e kryesuesit, sepse shpesh po kemi telashe administrative, kemi telashe me zërim dhe me kamerën që nuk është duke u funksionalizuar.

Të hyrat vetanake- sa herë kemi pasur raporte ose planifikime buxhetore e kam mbështetur iniciativën që ka marrë komuna për disiplinimin të të hyrave vetanake gjë që nuk ka qenë në të kalurën. Këto dy vitet e fundit ka një përmirsim të dukshëm dhe kjo ka reflektuar në realizimin e projekteve. Disa kategori që më kanë bërë përshtypje i kanë qoftë vlerat ma të ulta ose i kanë zero psh te drejtoria për bujqësi taksa nga ndërrim destitimi i tokës e kemi pasur zero në vitin 2023, prapë planifikohet zero të jetë dhe në vitin 2024. Taksa nga licenca e gurthyesve është zero dhe jemi në rregullit me këtë pjesë, sepse egziston një vendim. Taksa nga shfrytëzimi i pyjeve e kemi zero në vitin 2023 dhe vazhdon dhe në vitin 2024 të jetë zero. Taksa nga qiraja e tokës bujqësore, nuk e di komuna a jep ndonjë pronë me qira për operatorët e ndryshëm dhe kjo është zero.

Taksa administrative për fletëkërkesë, unë e di që paguhet një taksë për këta që aplikojnë për subvencione të ndryshme dhe është e planifikime zero.

Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim-taksa nga largimi dhe deponimi i automjeteve unë e di që sa herë që ka aksidente në rrugë bëhet një pagesë për bartjen e automjetve dhe duhet të figurojnë këtu. Taksa për inspektimin e ambientit është zero dhe unë kam vërejtje për këtë kategori është e papërfillshme me qenë zero.

Taksa administrative për fletëkërkesë nuk po e kuptoj saktë, është zero.

Drejtoria e arsimit të hyrat nga qerdhja kemi një rritje.

Drejtoria për shëndetësi është taksa administrative për fletëkërkesë është zero.

Drejtoria për kulturë rini dhe sport- të hyrat nga biblioteka, nuk e di a gjemeron të hyra biblioteka këtu është zero. Drejtor, ndoshta është mirë që në seancë ti kemi në seancë një arsyeshmërie për këto kategori dhe pse këto të hyra nuk figurojnë në komunën tonë.

Blerim Thaçi: Te qështja e taksimit të mjeteve kërkesa ka raste që hyjnë si taks komunale me një kod tjetër jo specifikish me emërtim. Te qështja e rritjes së buxhetit sipas planifikimit të qeveris është 19,895,800.00E dhe ne duke l rritur të hyrat me 500.000.00E ka mbërritur në shumën 20,395,806.00E. Te zyra e kryetarit që the ka një rritje te paga dhe meditje është sepse e kemi futur stafin në buxhet. Te qështa e rregullimit të sallës unë pajtohem dhe nuk na bënë telashe neve se nga cila pjesë, por e kemi një kërkesë që kërkohet që ti zvogëlojm shpenzimet sidomos te kategoria mallra dhe shërbime.

Veton Zogaj: Qarkorja e dytë pritët me ardhë në gusht apo?

Blerim Thaçi: Deri në fund të gushtit duhet me qenë e përfundimë. Nga mallra dhe shërbime janë paguar dhe llaptopët.

Argjend Thaçi: Si zyre e kuvendit asnjë cent nuk është shpenzuar, vetëm ndonjë komision që është paguar.

Blerim Thaçi: Ne kemi pasur problem për shkak të vendimit që nuk janë paguar komisionet.

Argjend Thaçi: Të gjitha Komitetet dhe Komisionet janë të formuara nga Kuvendi me kriter të punës.

Blerim Thaçi: Këto Komitetet jo obligative ne i bëjmë, sepse nuk janë të obligueshme me i pagu. Keni parasysh aktivitetin që e keni në fshatra janë 22 takime të gjitha këto duhet me u pagu.

Hamit Lima: Dhe kryetarët e fshatrav kanë me u pagu.

Veton Zogaj: Sa i përket zyrës së Kuvendit në të kaluarën 45.000.00E që i ka pas ai i ka shfrytëzu në cent dhe ka bërë udhetime zyrtare. Këtë 35.000.00E është urgjente me e rregullu sallën në Kuvend.

Blerim Thaçi: Kjo është qarkorja e parë dhe tani kur të shkon në Kuvend mundeni me ba 45 ose 50.

Argjend Thaçi: Renovimi i sallës së Kuvendit a duhet me vendos tani me kapitale apo si shkon.

Blerim Thaçi: Shkon nga mallra dhe shërbime.

Argjend Thaçi: Kush është për që Komizës Afatmesme 2024-2026 të rekomandohet për Kuvend?
Me vota unanime, kjo pikë rekomantohet për Kuvend.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllut. Faleminderit për pjesmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora: 10:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

